

Aplikimi për leje ndërtimi për ndryshimin e subjektit të lejes së ndërtimit në Këshillin Kombëtar të Territorit

Në bazë të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe në mbështetje të VKM-së nr. 725, dt. 2.9.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit", që prej muajit nëntor 2015 ka filluar punën Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), si një institucion publik qendror në varësi të ministrit përgjegjës për zhvillimin urban. Ajo kryen funksionet e Sekretariatit Teknik pranë Këshillit Kombëtar të Territorit.

Me shërbimin me një ndalesë dhe procedura të thjeshtuara, transparente dhe të shpejta, AZHT-ja redukton barrierat administrative dhe përmirëson praktikën e aplikimit për lejet përkatëse.

Dokumentacioni i nevojshëm për leje ndërtimi për ndryshimin e subjektit të lejes së ndërtimit në Këshillin Kombëtar të Territorit:

Dokumentet tekniko-ligjore të nevojshme për të aplikuar për lejen e ndërtimit, pranë AZHT-së (sipas përcaktimeve të nenit 40 të ligjit nr.107/2014):

- Kërkesë e subjektit të pajisur me leje ndërtimi e cila plotësohet elektronikisht përmes sistemit të lejeve të ndërtimit;
- Marrëveshja midis palëve që vërtetojnë kalimin e titullit mbi lejen e ndërtimit;
- NIPT i subjektit që i transferohet leja e ndërtimit;
- Ekstrakt QKB i subjektit që i transferohet leja e ndërtimit;
- Licencat e subjektit që i transferohet leja e ndërtimit.

Hapat e procedurës:

- Kërkesa për leje për ndryshimin e subjektit të lejes së ndërtimit, bëhet me kërkesë të subjektit të pajisur me leje ndërtimi. Kërkesa paraqitet për shqyrtim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, i cili mundëson edhe ngarkimin, lehtësisht, të dokumentacionit shoqëruar të kërkesës për leje ndërtimi.
- Sekretariati teknik pranë Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) shqyrton kërkesat për leje për ndryshimin e subjektit të lejes së ndërtimit brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së tyre. Në rast mangësie në dokumentacion, njoftohet aplikuesi të kryejë plotësimin e dokumentacionit.
- Në mbledhjen e radhës së saj, KKT-ja vendos për:
 - miratimin e lejes për ndryshimin e subjektit të lejes së ndërtimit
 - refuzimin e lejes për ndryshimin e subjektit të lejes së ndërtimit
- Vendimi i KKT-së njoftohet nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit dhe botohet në regjistër nga Sekretariati i KKT-së, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit.

Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit:

Brenda 30 ditëve nga kërkesa për leje. Në mbledhjen e radhës të KKT vendoset në rend dite për shqyrtim dhe miratim.